

KUVENDOJMË



SË BASHKU

ZËRI I NJERËZVE

LEORA (14), GRESA (14), SHKURTE D. (15), SHKURTE I. (14), DARDAN (15), LINDON (15), ALBIN (14)




Demokracia është zëri i njerëzve në veprim, është zëri i atyre që kanë diçka për të thënë

Ne jemi nxënës të klasës së nëntë. Vijmë nga shkol-la fillore „Dëshmorët e Lubishtës“ nga qyteti i Vitisë, më saktësisht nga fshati Lubishtë. Sot ne jemi këtu në Punëtorinë e Demokracisë në „Demos-ti“. Ne si gaze-tarë kemi mbledhur disa informacione për demokra-cinë të cilat mund t'i lexoni më poshtë. Demokracia është formë e qeverisjes në të cilën shumica e njerëz-ve ushtrojnë sovranitetin e tyre. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë qeverisje. Për herë të parë kjo formë e qeverisjes lindi në Athinë, në vitin 507 p.e.s. Demokracia nuk është thjesht një sistem rregullash të cilat i praktikojmë, por është zëri i popullit. Kemi dy lloje të demokracisë, demokracinë direkte dhe demokracinë përfaqësuese. Në demokracinë direkte

vendimet merren në mënyrë të drejtpërdrejtë, kurse në demokracinë përfaqësuese qytetarët e një vendi zg-jedhin përfaqësuesit e tyre përmes votave. Republika e Kosovës është republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e ba-lancimit ndërmjet tyre. Kjo është shumë e rëndësish-me për ne, sepse demokracia në Kosovë na mundëson respektimin e të drejtave tona. Disa nga këto të drejta janë: e drejta e shkollimit, e drejta e emrit, e drejta e lojës, e drejta e votës mbi moshën 18 vjeçare etj. Ndërsa, ne si qytetarë të Kosovës kemi disa përgjeg-jësi siç janë: për të mësuar, për t'i respektuar rregullat e shkollës, për t'i zbatuar rregullat e punës në vendin ku punon dhe mos të përdorim dhunë ndaj askujt. De-mokracia është diçka që duhet ta vëmë në jetë, dhe si çdo veprim tjetër i sofistikuar ajo duhet mësuar dhe praktikuar.



Gazetarët e këtij artikulli



E drejta për të shkuar në shkollë

KUVENDI YNË

FATLIND (15), ALBIN (14), BIONDINA (15), SARA (15), TAHIRE (14), BENITA (15), DRITA (14)



Artikulli më poshtë flet për Kuvendin dhe funksionet e tij

A e dini se cili është institucioni më i lartë i një shteti? Për ta mësuar këtë ju ftojmë të lexoni më poshtë.

Institucioni më i lartë demokratik i një shteti është Kuvendi. Besojmë se keni dëgjuar ndonjëherë për fjalën „kuvendoj“ që do të thotë bisedim. E pikërisht nga kjo fjalë e ka marrë emrin edhe institucioni ynë demokratik, Kuvendi i Kosovës. Në Kuvend ne përfaqësohemi nga deputetët të cilët i zgjedhim me votën tonë të lirë. Ndërkaq ata, bisedojnë në Kuvend për të zgjidhur të gjitha hallët dhe problemet e qytetarëve. Deputetët mbajnë mbledhje që quhen seanca plenare. Pikërisht në këto mbledhje diskutohet për problemet e qytetarëve, kurse ne mund t'i shohim këto seanca përmes kanaleve televizive, të cilat i transmetojnë seancat drejtpërdrejtë.

Kuvendi ka tri funksione kryesore. Funksioni i parë është funksioni legjislativ, sepse bën ose jo miratimin e ligjeve. Funksioni i dytë është funksioni kontrollues, sepse e kontrollon Qeverinë. Si dhe funksioni i tretë, funksioni përfaqësues, sepse na përfaqëson neve. Kuvendi ynë përbëhet nga 120 deputetë prej të cilëve 20 janë komuniteteve jo shumicë siç janë: turqit, egjiptianët, ashkalinjtë, romët, serbët dhe boshnjakët. Kuvendi po ashtu ka përgjegjësi të zgjedh edhe Presidentin e vendit. Kjo nënkupton që ne i zgjedhim deputetët, kurse ata e zgjedhin Presidentin, kuptohet duke

votuar.

Kjo ndodhë njëjtë sikurse klasa jonë që ka zgjedhur kryetaren e klasës dhe më pas, kryetarët e të gjitha klasave janë mbledhur dhe kanë zgjedhur kryetarin e shkollës sonë.

Ligjet që miratohen në Kuvend ndikojnë direkt në jetën tonë. Për ta kuptuar këtë më mirë, ne marrim shembull një ligj për shëndetësinë apo sigurimet shëndetësore, ku të gjithë qytetarët e Kosovës, do të ndikoheshin patjetër nga ky ligj.

Pas pak ne do të kemi mundësi ta vizitojmë Kuvendin dhe ta shohim atë nga afër. Pra Kuvendi luan një rol të rëndësishëm në jetën tonë si qytetarë të Kosovës. Porosia jonë është që Kuvendin ta shohim si një institucion që është pjesë e jetës sonë, si dhe ne jemi pjesë e tij.



Gazetarët e artikullit duke punuar

MENDIMET TONA VLEJNË

RAMADAN (14), NDERIM (15), SUELA (15), SELIMI (15), BLEONITA (14), LUMNIJE (14)

Nëse ju intereson më shumë rreth zgjedhjeve lexojeni këtë artikull

Populli në përgjithësi pa dallim të origjinës, moshës, racës, apo fesë, duhet t'i ketë të drejtat e barabarta, dhe këtë më së miri na e mundëson demokracia. Pra, me pak fjalë demokracia është zëri i popullit. Një proces shumë i rëndësishëm ku populli i zgjedh përfaqësuesit e vendit, është procesi zgjedhor. Populli ka nevojë që të ketë përfaqësues, të cilët duhet të jenë të besueshëm dhe ato premtime që ua japin popullit, t'i mbajnë. Kjo nënkupton që përfaqësuesit tanë, duhet të jenë të saktë dhe persona të fjalës. Populli me anë të votës i zgjedh përfaqësuesit e vendit të tij. Secili njeri mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtën e votimit, sepse në atë moshë është më i pjekur


dhe më i vetëdijshëm për vendimet që i merr. Kandidatët të cilët konkurojnë që të jenë deputetë kanë të drejtën e rizgjedhjes në postet paraprake. Në Kosovë, kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe ato komunale. Në zgjedhjet qendrore votohen deputetët, ndërsa tek ato komunale kryetari i komunës dhe asambleistët. Votimet mund të jenë të hapura dhe të mbyllura (të fshehta). Në demokracinë përfaqësuese qytetarët i zgjedhin udhëheqësit e tyre me votim të mbyllur, me qëllim që të mos ketë manipulime. Grupi ynë sot e ka kuptuar se sa është e vlefshme vota dhe ne me anë të saj mund të ndryshojmë të ardhmen tonë.



Një kandidate për deputete duke folur para qytetarëve



Grupi ynë duke bashkëpunuar



Voto për një ndryshim



Autorët e këtij artikulli



Përfaqësuesit tonë i zgjedhim duke votuar lirshëm



Gazetarët e Kuvendit



Puna në grup të vogël



Demokracia, qeverisje e popullit




Vota përgjegjësi e qytetarëve demokratik



Gazetarët duke punuar



Gjatë shkrimit të artikullit



Të drejtat dhe përgjegjësitë tona



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Dëshmorët e Lubishtës“
Klasa: 9/1
Vendi: Lubishtë, Viti